

### **AKT THEMELIMI**

Për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar  
**“SNUS ME ALBANIA” SH. P. K.**

Sot, më datën 20.04.2023 **Z. Gerald Alliaj** lindur në Durrës, Shqipëri, me datë 30 Korrik 1995, banues në Durrës, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe **Z. Enkelejd Çopa** lindur në Durrës, Shqipëri, me datë 26 Gusht 1992, banues në Durrës, vendosën të themelojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar **“SNUS ME ALBANIA” Sh. P. K.** si më poshtë vijon

#### **Neni 1**

Personat fizikë të sipërpërmendur, me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar, krijojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (Sh. P. K.) me emërtimin **“SNUS ME ALBANIA”**.

Ortakët e kësaj shoqërie janë **Z. Gerald Alliaj** dhe **Z. Enkelejd Çopa**

Administrator i kësaj shoqërie caktohet **Z. Gerald Alliaj** për një periudhë deri në 5 vjet.

Shoqëria ka të drejtë të krijojë filiale të saja brenda dhe jashtë vendit në çdo kohë që do të vlerësohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

#### **Neni 2**

Shoqëria **“SNUS ME ALBANIA”** gëzon statusin juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **“Sh. P. K.”**. Veprimtaria e saj do të zhvillohet sipas dispozitave të kësaj kontrate, statutit të saj dhe legjislacionit në fuqi.

Selia e shoqërisë **“SNUS ME ALBANIA” SH.P.K.** është DURRES, Lagjja 4, Rruga Fetah Bllaca, Pallati 1133, Kati i tretë, Zona Kadastrale 8514.

Statuti i shoqërisë i bashkangjitet këtij akti themelimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Shoqëria ka vulën e saj me logon dhe të dhënat të përcaktuara.

#### **Neni 3**

Veprimtaria e shoqërisë si person juridik fillon me aprovimin e krijimit të saj nga organet kompetente të shtetit dhe do të vazhdojë për një periudhë kohe pa afat të përcaktuar.

#### **Neni 4**

Shoqëria do të kryejë aktivitetet me objekt:

- Import-Export i artikujve të ndryshëm industrial e ushqimor
- Shitje me pakice dhe shumice e artikujve të ndryshëm industrial e ushqimor
- Shitje e online.
- Ushtrimin të çdo veprimtarie të ligjshme, të lejueshme për formën e shoqërisë, e cila nuk ndalohet me ligj sipas nenit 7 të ligjit tregtar nr.9901, dt.14.04.08.

#### **Neni 5**

Kapitali i shoqërisë është 100.000 Leke. Kapitali i shoqërisë ndahet në një numër kuotash në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri ku çdo ortak u zotëron një kuotë të vetme në shoqëri, kuota këto të shlyera si më poshtë:

*Gerald Alliaj*  


*Enkelejd Çopa*  


Z. Gerald Alliaj zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme 50.000 leke që përbën 50% të kapitalit të shoqërisë.

Z. Enkelejd Çopa zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme 50.000 leke që përbën 50% të kapitalit të shoqërisë.

Kontributi i ortakut mund të jete ne para ose ne natyre ( pasuri te luajtshme ose te paluajtshme apo te drejta ). Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

#### **Neni 6**

Fitimi neto nga aktiviteti i kësaj shoqërie i përket ortakut te saj.

#### **Neni 7**

Për detyrimet që do të krijohen ndaj personave të tretë gjatë aktivitetit të kësaj shoqërie do të përgjigjet vetë shoqëria deri në kufirin maksimal të kapitalit të saj.

#### **Neni 8**

Marrëdhëniet e punës në shoqëri dhe në filialet e saj rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

#### **Neni 9**

Dispozita të hollësishme mbi organinzimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj. Themeluesi i kësaj shoqërie, pasi lexoj me vëmendje këtë akt themelimi dhe e gjeti në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me vullnetin e tij, e firmosi pa vërejtje.

### **ORTAKËT E SHOQËRISË**

**Z. Gerald Alliaj**



**Z. Enkelejd Çopa**

